

# Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore

## Viti 2016


**Tiranë, më 20 Prill 2018:** Në vitin 2016, lënda e parë e nxjerrë nga burimet e brendshme natyrore, e cila përfaqëson sasinë totale të materialeve që përdoren direkt në ekonomi, është rreth 28 milion ton, duke shënuar një rritje me 7,97 % krahasuar me vitin 2015. Struktura e burimeve të brendshme natyrore, tregon që produktet “minerale jo metalike” zënë rreth 63,48 %, “biomasa” 28,56 %, “mineralet metalike” 4,15 % dhe “materialet e energjisë fosile” me 3,81 %.

**Tab. 1 Burimet e brendshme natyrore**

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Biomasa	7.726,99	7.836,32	7.882,53	7.966,59	8.117,51
Mineralet dhe koncentratet metalike	977,09	1.243,79	1.436,88	1.528,71	1.180,02
Mineralet jo metalike	10.971,19	13.058,92	12.351,07	15.413,90	18.047,05
Materialet fosile të energjisë	1.028,54	1.375,28	1.489,85	1.419,81	1.082,71
<b>Total</b>	<b>20.703,79</b>	<b>23.514,32</b>	<b>23.160,32</b>	<b>26.329,00</b>	<b>28.427,28</b>

(mijë ton)

**Fig.1 Struktura e burimeve të brendshme natyrore**



Shuma totale e importit të materialeve mjedisore në vitin 2016 ishte rreth 4 milion ton, e cila krahasuar me vitin 2015 është 3,04 % më e lartë. Pjesën më të madhe e zënë produktet e “biomasës” me 1.369 mijë ton të shoqëruar nga “materialet fosile të energjisë” me 891,12 mijë ton. Më pas kemi produktet “minerale jo metalike” me 770,37 mijë ton, “mineralet dhe koncentratet metalike” me 752,43 mijë ton dhe “produkte të tjera” ku përfshihen mbetjet e importuara me 282,17 mijë ton.

**Tab. 2 Importet e materialeve mjedisore**

(mijë ton)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Biomasa	1.143,00	1.179,41	1.242,29	1.233,87	1.369,55
Mineralet dhe koncentratet metalike	714,28	668,87	782,80	816,90	752,43
Mineralet jo metalike	963,58	832,97	854,25	810,53	770,37
Materialet fosile të energjisë	918,75	984,13	872,13	818,00	891,12
Produkte të tjera dhe mbetje të importuara	252,23	275,02	276,58	266,42	282,17
<b>Totali</b>	<b>3.991,82</b>	<b>3.940,39</b>	<b>4.028,05</b>	<b>3.945,72</b>	<b>4.065,64</b>

Eksportet në vitin 2016 arritën një vlerë prej rreth 4 milion ton, duke pësuar ulje me 6,72 % krahasuar me vitin 2015, ndikim më të madh në uljen e eksporteve në total e kanë dhënë “mineralet dhe koncentratet metalike” me 7,66 % dhe “materialet fosile të energjisë” me afërsisht 17,30 %. Rritje të eksporteve kanë sjellë “mineralet jo metalike” me 2,77 %

**Tab. 3 Eksportet e materialeve mjedisore**

(mijë ton)


Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Biomasa	223,41	233,62	248,16	333,31	331,20
Mineralet dhe koncentratet metalike	1.080,69	1.531,23	1.525,61	1.345,15	1.242,14
Mineralet jo metalike	1.338,01	1.265,36	1.424,85	1.232,28	1.266,36
Materialet fosile të energjisë	1.027,25	1.291,83	1.225,92	1.205,87	997,20
Produkte të tjera dhe mbetje të eksportuara	88,95	98,13	108,62	127,50	122,16
<b>Totali</b>	<b>3.758,30</b>	<b>4.420,18</b>	<b>4.533,16</b>	<b>4.244,10</b>	<b>3.959,04</b>

Bilanci fizik tregtar i cili tregon diferencën midis importeve dhe eksporteve për të gjithë kategoritë e materialeve mjedisore arriti vlerën e rreth 107 mijë ton për vitin 2016, duke pësuar rritje me 135,73 % krahasuar me vitin 2015 ku sasia e importuar e materialeve mjedisore ishte më e vogël se sasia e eksportuar. Produktet e “biomasës” dhe “produkte të tjera”, përfshirë mbetjet kanë një bilanc pozitiv ndërsa produktet “mineralet jo metalike”, “mineralet dhe koncentratet metalike” dhe “materialet fosile të energjisë” kanë një bilanc negativ për vitin 2016.

**Tab.4 Bilanci fizik tregtar**

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Bilanci Fizik Tregtar</b>	<b>233,52</b>	<b>-479,78</b>	<b>-505,11</b>	<b>-298,38</b>	<b>106,60</b>
Import	3.991,82	3.940,39	4.028,05	3.945,72	4.065,64
Export	3.758,30	4.420,18	4.533,16	4.244,10	3.959,04

**Fig.2 Bilanci fizik tregtar**




Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat sasinë totale vjetore të lëndëve të para që nxirren nga mjedisi, duke marrë në konsideratë dhe bilancin fizik tregtar. Në 2016 përdorimi i brendshëm arriti vlerën e rreth 28,5 milion ton, 9,62 % më shumë krahasuar me vitin 2015. Sipas strukturës së tij shohim që pjesën më të madhe e zënë “mineralet jo metalike” me 61,51 %, më pas vijën produktet e “biomasës” me 32,09 %, “materialet fosile të energjisë” me 3,42 %, “mineralet dhe koncentratet metalike” me 2,42 % dhe “produkte të tjera” me 0,56 %.

**Tab.5 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore**

(mijë ton)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Biomasa	8.646,58	8.782,11	8.876,66	8.867,15	9.155,86
Mineralet dhe koncentratet metalike	610,68	381,43	694,07	1.000,46	690,31
Mineralet jo metalike	10.596,75	12.626,53	11.780,48	14.992,15	17.551,06
Materialet fosile të energjisë	920,03	1.067,58	1.136,06	1.031,94	976,63
Produkte të tjera dhe mbetje	163,28	176,89	167,96	138,92	160,01
<b>Total</b>	<b>20.937,32</b>	<b>23.034,54</b>	<b>22.655,22</b>	<b>26.030,63</b>	<b>28.533,88</b>

**Fig.3 Struktura e përdorimit të brendshëm të materialeve mjedisore**



Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë në vitin 2016 ishte rreth 9,92 ton, duke treguar një rritje me afërsisht 6,12 % krahasuar me vitin 2010, e cila kishte një vlerë rreth 7,01 ton.

Tab.6 Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë

(ton / banorë)

Viti	2012	2013	2014	2015	2016
Biomasa	2,98	3,03	3,07	3,08	3,18
Mineralet dhe koncentratet metalike	0,21	0,13	0,24	0,35	0,24
Mineralet jo metalike	3,65	4,36	4,08	5,20	6,10
Materialet fosile të energjisë	0,32	0,37	0,39	0,36	0,34
Produkte të tjera dhe mbetje	0,06	0,06	0,06	0,05	0,06
<b>Totali</b>	<b>7,22</b>	<b>7,96</b>	<b>7,84</b>	<b>9,04</b>	<b>9,92</b>

# Shënime metodologjike

Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore është një nga modulet e Llogarive Ekonomike në Mjedis. Qëllimi i tyre është integrimi i informacionit mjedisor në një mënyrë koherente me sistemin qendror të Llogarive Kombëtare.

Llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore ka për objekt kryesor të përshkruaj lidhjen midis ekonomisë vendase dhe mjedisit natyror. Ajo përfshin sasinë totale të burimeve natyrore dhe produkteve të përdorura në ekonomi, në mënyrë direkte në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve dhe shërbimeve, ose indirekt përmes nxjerrjes së materialeve të cilat do të përdoren për prodhim.

Këto të dhëna janë subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rrethnesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Disa nga kategoritë kryesore dhe indikatorët kryesorë të llogarive të flukseve të materialeve mjedisore janë:

## **Biomasa**

Biomasa përfshin materialet organike jo fosile me origjinë biologjike. Sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve të Materialeve Mjedisore, lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin të gjithë produktet bujqësore, peshqit dhe kafshët e gjuetisë. Blegtoria dhe produktet blegtorale (si p.sh qumështi, mishi, vezët) nuk përfshihen në këtë kategori.

## **Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike**

Mineralet metalike dhe mineralet jo metalike të përpunuara dhe të pa përpunuara janë dy grupe kryesore në kategoritë e materialeve mjedisore, sipas përkufizimeve të Llogarive të Flukseve Materiale Mjedisore, që përbëhen nga prodhimet e minierave, industria e ndërtimit dhe mineralet industriale.

## **Materialet Fosile të Energjisë**

Përfshijnë burimet e naftës dhe materialet e tjera fosile të energjisë që janë formuara në të kaluarën gjeologjike, nga biomasa. Ato përfshijnë lëndet e ngurta, lëngjet dhe gazet.

## **Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore**

Lënda e parë e nxjerrë nga burimet natyrore përfshin sasinë vjetore të lëndëve të para (me përjashtim të ujit dhe ajrit) të nxjerra nga mjedisi natyror për t'u përdorur në ekonomi, për qëllime ekonomike.

**Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore**

Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore mat shumën vjetore të lëndëve të para të nxjerra dhe të përdorura në ekonominë kombëtare, plus të gjitha importet fizike, minus të gjitha eksportet fizike.

**Bilanci i Fizik Tregtar**

Bilanci fizik tregtar është i barabartë me importet fizike minus eksportet fizike.

**Burimi i të dhënave**

Te dhënat e përdorura për Llogaritë e flukseve të Materialeve Mjedisore kanë burim të dhëna administrative të marra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Instituti i Statistikave (INSTAT) etj.

Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me rregulloren (BE) Nr 691/2011 mbi Llogaritë e Flukseve të Materialeve Mjedisore dhe manualeve të Eurostat.